



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:101277
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05761319

C – II. – 17- 0202 - C0001

Paditësi:

I C nga fshati S i E i Komunës së Vushtrrisë.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lagjja, "Lakrishtë" Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i dëmit për mos pagesën në tërësi të 20 %-shit.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.31.05.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, I C nga fshati S i E i Komunës së Vushtrrisë e me të cilën ka kërkuar që :''padia dhe kërkesëpadia e paditësve nga Lista Përfundimtare legjitime e publikuar nga AKP-ja me datat 4, 5 dhe 7 Mars të vitit 2009, dhe të vërtetohet e drejta në pagesën nga fondi i 20 %, si e drejtë e fituar me Listën e shpallur nga AKM-ja me datat, 4, 6 dhe 7 mars 2009, në tërësi, dhe të detyrohet, AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, të u paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSh-së, dhe pagesa të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë''.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Me dt.30.08.2013, paditësit, B A nga Prishtina etj, e në mesin e tyre, edhe paditësi, I C nga fshati S i E i Komunës së Vushtrrisë, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGjSK), kanë parashtruar padinë e përbashkët prej 535 ish punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim) për kompensimin e dëmit – mos pagesën e 20 % -it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar në mjetet e informimit me dt.04, 05 dhe 07 Mars të vitit 2009 e me propozimin që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerr aktgjykim e me të cilin aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësve nga Lista Përfundimtare legjitime e publikuar nga AKP-ja me datat 4, 5 dhe 7 Mars të vitit 2009, vërtetohet e drejta në pagesën nga fondi i 20 %, si e drejtë e fituar me Listën e shpallur nga AKM-ja, me datat, 4, 6 dhe 7 mars 2009, në tërësi, dhe të detyrohet, AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, të u paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSh-së, dhe pagesa të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Paditësit në këtë padi në mes tjerash kanë theksuar se janë përfitues të 20 %-shit nga privatizimi i NSh, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, të cilën AKM-ja, e ka privatizuar me dt.27.06.2006, nga Lista përfundimtare e të të punësuarve në NSh në momentin e privatizimit, e cila ishte hartuar konform dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, nenet 10.1, 10.2, 10.3, dhe 10.4 me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6, se kjo listë pasi që është përpiluar nga organi përfaqësues i ndërmarrjes, i ishte dorëzuar AKM-së, gjegjësisht Komisionit për përpilimin e Listës Përfundimtare të përfituesve të së drejtës së përfitimit nga Fondi i 20 %-it të NSh-së, se komision kishte përpiluar Listën Përfundimtare të të punësuarve legjitim të cilët në momentin e privatizimit ishin të punësuar në NSh dhe ishin në listën e pagave të këtij subjekti më shumë se tre viteve, andaj me subjektin e privatizuar kishin raporte të veçanta dhe në të kishin një vend pune, se Lista Përfundimtare e AKM-së e përpiluar nga komisioni adekuat dhe e vërtetuar nga Bordi i Drejtorëve të AKM-së, u publikua në disa prej mediave ditore të informimit sipas nenit 10.3 të UNMIK-ut, Nr.2003/13, me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, se Lista Përfundimtare i kishte përfshirë vetëm punëtorët të cilët i plotësonin kushtet sipas Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.1, dhe 10.4 me ndryshimet e saj me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6, në momentin e privatizimit, edhe 98 të cilët nuk i plotësonin kushtet në tërësi sipas dispozitave ligjore.

Tutje kanë shtuar se pas shpërndarjes së pagesave me ç'rast secili individ nga Lista Përfundimtare, e kuptuan se i janë shkëlur të drejtat e tyre legjitime dhe janë dëmtuar secili prej tyre për nga 5,060.00 € e me këtë shpërndarje të kryer nga ana e AKP-së dhe me kontestin e zhvilluar në Dhomën e Posaçme, se të punësuarit pasi që nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk kanë qenë të informuar në asnjë mënyrë për këtë procedurë as nga Dhoma e Posaçme e as nga AKP-ja, pasi që kanë marrë këstin e dytë ata e kanë themeluar një këshill prej 19 anëtarësh nga Lista Përfundimtare e të punësuarve, se paditësit janë dëmtuar me veprimet dhe me mosveprimet e AKP-së, të cilat mund të shihen në procedurën e zhvilluar në Dhomën e Posaçme me shifrën, SCEL – 09 – 0001 dhe ASC – 11 – 0035, se në shkallën e parë, Trupi gjykues, ua kishte aprovuar ankesat e 735 ankuesve të Listës Përfundimtare dhe legjitime të AKP-së, duke e shpallë "nule" Listën Përfundimtare të të punësuarve e duke e udhëzuar të paditurën që të përgatis "një listë të re" për shkaqe procedurale (përbërja e komisionit) e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësit, kësaj padie, i kanë bashkangjitur këto prova : Vendimin e Kryesisë së Sindikatës së Pavarur të NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë për autorizimin e K B nga Prishtina, që t'i përfaqësoj së bashku me listën e punëtorëve për përvojën e punës prej dt.29.06.199 – 27 .06.2006 dhe përvojën e punës prej fillimit të KNI, "Ramiz Sadiku" deri me dt.27.06.2006, Aktvendimi, Fi.64/89 i dt. 14.02.1990 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë për themelimin e NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, Fi.6826/92 të dt.13.11.1992 për transformimin e NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë, kopjen e aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë – Dhomës së Falimentimit, FA.nr.2/89 të dt.16.10.1989 për hapjen e procedurës së falimentimit të NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë, kopjen e Vendimit, Nr.4 të dt.28.06.1999 të Këshillit Organizativ të KNI, "Ramiz Sadiku" për ndërrimin e emrit të Ndërmarrjes Ndërtimore Industriale, "GRADING", KNI, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, kopjen e Vendimit, Nr.10 të dt.03.07.1999 të Këshillit Organizativ të KNI, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, kopjen e Vendimit, Nr.10 të dt.03.07.1999 të Këshillit Organizativ të KNI, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, kopjen e Vendimit, Nr.4/1 të dt.26.06.1999 të Këshillit Organizativ të KNI, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, kopjen e certifikatës së dt.09.01.2002 të UNMIK-ut, për regjistrimin e KAN, "Ramiz Sadiku", Prishtinë – Tiranë, kopjen e kundërshtimit të anëtarëve të Kryesisë së Sindikatës së Kompanisë Aksionare Ndërtimore, "Ramiz Sadiku", Prishtinë të ushtruar pranë DHPGJSK-së kundër Listës Përfundimtare të të punësuarve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 (me ndryshime), e përpiluar dhe publikuar dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me listën e emrave të tyre (98 sish), kopjen e shkresës së dt.13.12.2011 të Kryesisë së Sindikatës së NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë të drejtuar pranë DHPGJSK-së, kopjen e Vendimit të dt.22.08.2011 të kryesisë së Sindikatës së NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë për autorizimin e kryetarit të saj që ushtrroj padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme së bashku me emrat e të të punësuarve, kopjet e 6 (gjashtë) faqeve të Aktgjykimit të DHPGJSK-së, ASC – 11 – 0069 – A00073 të dt.24.11.2011 dhe shkresave të tjera të kësaj lënde, kopjen e aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë – Dhomës së Falimentimit, FA.nr.2/89 të dt.16.10.1989, kopjen e ankesës së përfaqësuesit të Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të NSh, "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë kundër Vendimit, SCEL të DHPGJSK-së, dhe kopjet e shkresave të lëndës, **C – II – 13- 0338 – C0001**.

Me dt.30.10.2013, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje në padinë e paditësve për kompensimin e dëmit respektivisht për mos pagesën e 20 %-it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar nga AKP-ja në muajin mars 2009, se paditësit kanë theksuar se ankesën e kanë parashtruar kundër Listës përfundimtare të publikuar nga AKP-ja për arsye se në këtë listë janë përfshirë edhe 98 persona të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, se trupi gjykues i DHPGJSK-së, ka refuzuar ankesat e tyre e me të cilin përveç 98 punëtorëve të pranuar nga AKP-ja, i kishte përfshirë në këtë listë për përfitimin e 20 %-it edhe 714 ankues në kundërshtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 dhe se ata tash kanë parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, se DHPGJSK-ja, gabimisht ka komentuar dhe konkluduar në lidhje me statusin e Ndërmarrjes shoqërore, KNI "Ramiz Sadiku", se paditësit siç duket nuk janë kënaqur me Vendimet e DHPGJSK-së lidhur me përfshirjen në listë edhe të një numri të madh ankuesish, dhe se në këtë mënyrë ata janë të dëmtuar, se paditësit kërkojnë nga DHPGJSK-ja, që të merr aktgjykim e me të cilin aprovet padia e paditësve dhe të detyrohet, AKP-ja, që 535 punëtorëve të përfshirë në Listën Përfundimtare të publikuar në vitin 2009, t'u paguaj edhe nga 5,060.00 . Tutje e paditura në këtë mbrojtje, ka sqaruar rrjedhën e procedurës dhe para publikimit të Listës Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë të ardhurave nga privatizimi i NSh "Ramiz Sadiku", Prishtinë dhe të publikuar në vitin 2009 e deri te nxjerrja e aktgjykimi të Kolegjit të DHPGJSK-së, SCEL – 09 – 0001 të dt.10.06.2011, e me të cilin është pranuar një

numër të madh të ankesave si të bazuar dhe e urdhëroj AKP-në, që t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-it derisa pjesërisht e ka pranuar si të bazuar ankesën e ankuesve, C -540 - 1 e duke i hequr nga lista 8 punëtorë dhe duke e refuzuar ankesën për heqjen e punëtorëve të tjerë e më pas, pas ankesës së ushtruar nga AKP-ja dhe Sindikata e Punëtorëve të NSh-së në fjalë kundër këtij aktgjykimi, Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, me aktgjykimin e tij, ASC – 11 – 0069 – A00073 të dt.24.11.2011, ka pranuar një numër të madh të ankesave të punësuarve dhe e urdhëroj AKP-në, që t'i përfshij ata në Listën Përfundimtare për 20 %-i ndërsa e refuzoj si të pabazuar ankesën e AKP-së, Nr.A 0016 dhe të Sindikatës së Punëtorëve të NSh-së, Nr.A 0073.

Në këtë mbrojtje, e paditura, AKP-ja ka deklaruar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre e duke i konsideruar si të pabazuara, se në lidhje me Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë të ardhurave nga privatizimi i NSh, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, në kohën e paraqitjes së ankesave (në vitin 2009) dhe marrjes së aktgjykimit (në vitin 2011), ka qenë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut, Nr.2003/13 (me ndryshime), Rregullorja Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, se Rregullorja e UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.6, parasheh se : ***"Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garanci mbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5 , i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1. (g) të Rregullores, Nr.2003/13"***, se neni 10.6 (a), parasheh se: ***"Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes së Listës Përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 103 të Listës së të punësuarve me të drejta legjitime"***, se Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave i DhPGJS-së në lëndën, SCEL – 09 – 0001 dhe ASC – 11 – 0069 – A00073, kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet e Sindikatës së Punëtorëve të NSh-së, duke dhënë arsyet sepse ankesat e tyre janë refuzuar, prandaj konsiderojnë se çështja ka përfunduar, pasi që nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar Listën Përfundimtare, as me ligjet që ishin në fuqi as me ligjet që tash janë në fuqi (Ligji, Nr.04/L – 034 për AKP-në), se në bazë të Rregullores, Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, dhe Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, Vendimet e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet ndonjë ankesë tjetër, se siç shihet nga e tëra që u tha më lartë, paditësit pretendojnë se përveç 98 punëtorëve të përfshirë në Listë nga AKP-ja, janë përfshirë edhe 714 punëtorë të tjerë nga Dhoma e Posaçme, dhe në këtë mënyrë punëtorët e përfshirë në listën e shpallur në mars të vitit 2009, janë dëmtuar secili prej tyre për nga 5,060.00 euro, se fakti i thjeshtë se paditësit, janë të pa kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të parashtrorjnë sërish ndonjë ankesë tjetër apo paditë të bazuar në ligj dhe për të njëjtën çështje, pasi që çështja është gjë e gjykuar (res iudicata), e kjo është argumentuar edhe me një numër të konsiderueshëm me Vendime të Kolegjit të Apelit lidhur me NSh, "Ramiz Sadiku" si psh, AC -1- 12 – 0145, AC -1- 13 – 0174, AC -1- 12 – 0145, ASC – 11 – 0069 – A0104 etj, se po ashtu sipas nenit 24 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në (ligji i vjetër), thuhej se : ***"Secili parashtrues dhe palë kundërshtare përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo i odës së avokatëve"***. Pa marrë parasysh dispozitën më lartë, personat fizikë mund të lejohen të përfaqësojnë vetveten përveç nëse kryesuesi i kolegjit nxjerr një Urdhër sipas paragrafit 3 të këtij neni", se parashtruesit e padisë, nuk kanë parashtruar ndonjë provë materiale për të vërtetuar se është anëtarë i Odës së Avokatëve ashtu siç parashihet me nenin 24.1 të Shtojcës së Ligjit për DhPGJS-në, Nr.04/L – 033, prandaj as personi i quajtur, K B e as R D në emër të Sindikatës së Punëtorëve, nuk mund t'i përfaqësojnë paditësit e tjerë në DhPGJSK, sipas nenit 24 të Ligjit, Nr.04/L 033 për derisa ata nuk e përfaqësojnë vetveten në kuptim të nenit 24.2 të këtij Ligjit, si dhe i kanë propozuar gjykatës që të lëshoj aktvendim e me të cilin padinë e paditësve, do të hedhet poshtë si e pa pranueshme apo padia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar e më gjerësisht si në këtë Mbrojtje.

Me dt.10.11.2017, DhPGJK-ja me Urdhrin e saj të brendshëm, C – II. – 13 – 0338 – C0001 të dt.10.11.2017, lëndën, **C – II. – 13 – 0338 – C0001**, e paraqitur në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) – Kolegji i specializuar II, e cila ka qenë e përbërë prej 536 ankuesve të ndryshëm, përmes këtij Urdhri, Zyra e Regjistrimit, është urdhëruar që të i ndaj këta ankues veç e veç e duke e caktuar secilin prej tyre në një lëndë dhe me numër të veçantë dhe se kjo lëndë, ka marrë numrin, **C - II – 17 – 0202 – C0001**.

Me dt.14.11.2023, DhPGJK-ja me Urdhrin e saj, C – II. – 17 – 0090 – C0001 të dt.14.11.2023, në lëndën, **C - II – 17 – 0090 – C0001**, ka urdhëruar të paditurën, AKP-në me seli në Prishtinë, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditë së pranimit të këtij urdhri, pranë kësaj gjykate, duhet të parashtrij/dorëzoj, sqarim lidhur me çështjen e kërkesës së paditësit, S A nga Prishtina dhe të tjerët si ish punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe që kësaj gjykate, t' ia përcjell të dhënat gjegjëse, se sa ka qenë Fondi i Privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim), në momentin i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare e punëtorëve të kësaj NSH-je dhe atë në shumën prej 3,500.00 euro e cila, u ishte paguar në dy këste, si dhe se Fondi i Privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim), a është shtuar me mjete tjera monetare, pas pagesës së një pjese të Fondit të 20 %-it të kësaj NSH-je deri në vendimmarrjen e bërë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), në lëndën, SCEL – 09 – 0001, në shkallën e parë dhe në lëndën e Kolegjit të Apelit, ASC – 11 – 0035, kur ua kishte aprovuar ankesat e 735 ankuesve të Listës Përfundimtare dhe legjitime të AKP-së, duke e shpallë "nule" Listën Përfundimtare të të punësuarve e duke e udhëzuar të paditurën që të përgatis "një listë të re" për shkaqe procedurale (përbërja e komisionit).

Me dt.22.11.2023, e paditura, AKP-në me seli në Prishtinë, ka dhënë Përgjigje në Urdhrin e kësaj gjykate, C – II. – 17 – 0090 – C0001 të dt.14.11.2023 dhe duke sqaruar se Listës Përfundimtare e punëtorëve të kësaj NSH-je, është publikuar konform nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 (me ndryshime) me dt.5, 6, dhe 7 mars 2009 gjersa afati për ankesë për çfarëdo pretendimi ndaj listës së publikuar pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ka qenë deri me 27 Mars 2009, dhe se në këtë listë kanë qenë të përfshirë 536 punëtorë gjersa me aktgjykim final të Dhomës së Posaçme, ASC – 11 – 0069, në listë të përfituesve të 20 %-it, janë përfshirë edhe 749 punëtorë e numri total i punëtorëve të kualifikuar për përfitimin e fondeve të 20 %-it, është 1285, se vlera totale e shitjeve të asteteve të NSH-së, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, në momentin e shpërndarjes preliminare të 20 % -it për punëtorët e kualifikuar, ka qenë 22,939,860.00 €, gjersa shuma totale e 20 %-it të vlerës së shitjes, ka qenë 4,587,972.00 € e në total vlera e shitjes së asetëve të NSH-së në fjalë, deri më tani ka qenë 23,562,582.00 € gjersa 20 %-shi i vlerës totale të shitjeve që i ka takuar punëtorëve të kualifikuar, ka qenë 4,712,516.00 €, si dhe se Agjencia ka bërë shpërndarjen e fondeve të 20 %-shit konform nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 (me ndryshime) dhe se me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të gjyqimit, një kopje e kësaj Përgjigje të të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë, është vendosur edhe në lëndën, **C - II – 17 – 0202 – C0001**.

Arsyetimi ligjor:

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), është e rregulluar Ligjin,

nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (tutje DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit, Nr.06/L-086 të DhPGJSK-së, vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual, nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente .

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, IC nga fshati S i E i Komunës së Vushtrrisë, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata konstaton se Ndërmarrja Shoqërore, (NSH) "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim), është privatizuar nga ish AKM-ja me dt.27.06.2006 kurse paditësi sikurse edhe të punësuarit e tjerë të kësaj NSH-ja, ka qenë përfitues i 20 %-it nga privatizimi i kësaj NSH-je, dhe atë nga Lista Përfundimtare e të të punësuarve në NSH në momentin e privatizimit dhe e hartuar sipas nenit 10.1, 10.2, 10.3 dhe nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 e me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6 dhe se i njëjti, ka marrë shumën prej 3,500.00 euro dhe e cila ia kishte paguar, në dy këste. Mirëpo duke qenë se në rastin konkret, Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me aktgjykimin e saj të nxjerrë në shkallë të parë, SCEL – 09 – 0001 të dt.10.06.2011 e me të cilin është pranuar një numër i madh të ankesave si të bazuara dhe e ka urdhëruar AKP-në, që t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-it derisa pjesërisht e ka pranuar si të bazuar ankesën e ankuesve, C - 540 -1 e duke i hequr nga lista 8 punëtorë dhe duke e refuzuar ankesën për heqjen e punëtorëve të tjerë e pas ankesës së ushtruar nga AKP-ja dhe Sindikata e Punëtorëve të NSH-së në fjalë kundër këtij aktgjykimi, Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, me aktgjykimin e tij, ASC – 11 – 0069 – A00073 të dt.24.11.2011, i ka pranuar një numër të madh të ankesave të punësuarve dhe e ka urdhëruar, AKP-në, që ata t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-i ndërsa ua ka refuzuar si të pabazuara, ankesën e AKP-së, Nr. A 0016 si dhe ankesën e Sindikatës së Punëtorëve të NSH-së, Nr.A0073 derisa kërkesa për kompensimin e dëmit - për mos pagesën e 20%-it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar në mjetet e informimit me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, është bërë brenda afatit të paraparë nga neni 72 i Ligjit Nr.06/L-086 të DhPGJSK-së që bënë fjalë për Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime dhe se kjo kërkesë i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 72 të Ligjit Nr.06/L-086 për DhPGJSK-në.

Faktet jo kontestueses dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata ka vlerësuar se me këtë gjendje të tillë të shkresave të lëndës, Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), si gjykatë kompetente për të vendosur, konstaton se objekti i kësaj çështje juridike kontestimore lidhur me kompensimin e kërkuar të paditësve dhe që të detyrohet, AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, t'u paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSH-së.

Neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-it, Nr.2003/13, ka rregullura të drejtat e të punësuarve dhe procedurën për përfitimit të 20 %-it nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore.

Neni 10.2 i Rregullores së lartcekur përcakton se si organi përfaqësues i NSH-së në bashkëpunim me Sindikatën e Pavarur përpilon Listën Preliminare dhe të njëjtën ia dërgon Agjencisë që ta shqyrton listën dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje për të gjithë të punësuarit.

Neni 10.3 i Rregullores së lartcekur përcakton se Lista zyrtare – përfundimtare e të punësuarve me të drejta legjitime lëshohet nga agjencia me njoftimi për të drejtën në ankesë në pajtim me Nenin 10.6 dhe publikohet në gazetën kryesore në gjuhën shqipe dhe serbe .

Neni 10.4 i Rregullores së lartcekur përcakton se punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i NSh-së në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në Listën e Pagave të NSh-së për jo më pakë se tre (3) vite, kjo e drejtë nuk i ndalon edhe punëtorët të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin në regjistër si punëtor po mos të ishin të diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

Neni 10.6 i Rregullores së lartcekur përcakton se pas paraqitjes së kërkesës nga individit me të drejtë të cenuar ankesa lidhur me listën e punëtorëve me të drejtë legjitime i dërgohet Dhomës së Posaçme për shqyrtim.

Neni 10.6 pika (a) tregon kohën që brenda njëzetë (20) ditësh pas shpalljes përfundimtare të listës në media sipas nenit 10.3. 3 të Rregullores së UNMIK-it, Nr.2003/13 .

Në nenin 72 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), që flet për Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, aty thuhet se :'' *Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6 të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë ligj e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiuar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim''.*

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse e veçmas pretendimin e të paditurës, AKP-së, me seli në Prishtinë të paraqitur përmes Mbrojtjes së saj në padinë e paditësve lidhur me atë e në rastin konkret kemi të bëjnë me çështjen e gjësë së gjykuar – res iudicata, por sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në rastin konkret, paditësit kanë paraqitur kërkesa të veçanta lidhur me kompensimin gjegjës rreth 20 %-it tani më të shpërndarë e në 2 (dy) kësteve deri më tani tek të punësuarit e NSh, ''Ramiz Sadiku'' me seli në Prishtinë (në likuidim).

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës.

Gjykata pas administrimit të provave, vlerësimit të tyre, ka konstatuar gjendjen faktike gjegjëse dhe ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret, e paditura, ish AKM-ja, e tani AKP-ja, Ndërmarrjen Shoqërore, (NSH) ''Ramiz Sadiku'' me seli në Prishtinë (në likuidim), e ka privatizuar me dt.27.06.2006, e ka hartuar Listën përfundimtare e të të punësuarve në këtë NSh në momentin e privatizimit, dhe e cila ishte hartuar konform dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, nenet 10.1, 10.2, 10.3, dhe 10.4 me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA) të UNMIK-ut, Nr.2008/6, pra se kjo listë ishte përpiluar nga organi përfaqësues i ndërmarrjes, dhe i ishte dorëzuar ish AKM-së, gjegjësisht Komisionit për përpilimin e Listës Përfundimtare të përfituesve të së drejtës së përfitimit nga Fondi i 20 %-it të NSh-së, e më pas, komisioni kishte përpiluar Listën Përfundimtare të të punësuarve legjitim e të cilët në

momentin e privatizimit, ishin të punësuar në NSh dhe ishin në listën e pagave të këtij subjekti më shumë se tre viteve, se Lista Përfundimtare e AKM-së e përpiluar nga komisioni adekuat dhe e vërtetuar nga Bordi i Drejtorëve të ish AKM-së, ishte e publikuar në disa prej mediave ditore të informimit sipas nenit 10.3 të UNMIK-ut, Nr.2003/13, me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, dhe se në këtë Listë Përfundimtare, i kishte përfshirë vetëm punëtorët të cilët i plotësonin kushtet sipas Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.1, dhe 10.4 e me ndryshimet e saj me Udhëzimin Administrativ, (UA) të UNMIK-ut, Nr.2008/6, në momentin e privatizimit, andaj me gjendjen e tillë, nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar Listën Përfundimtare, as me ligjet që ishin në fuqi as me ligjet që tash janë në fuqi (Ligji, Nr.04/L – 034 për AKP-në), se në bazë të Rregullores, Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, 2008/6, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, dhe Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe se nga Kolegji i Ankesave i DhPGjSK-së në lëndën, SCEL – 09 – 0001 dhe ASC – 11 – 0069 – A00073, kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet e Sindikatës së Punëtorëve të NSh-së, se pas me vendimmarrjes në fjalë, dhe në bazë të sqarimeve të bërë nga e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, në Përgjigjen e saj të dt.22.11.2023, gjykata ka vlerësuar se çështja e paditësit, ka përfunduar, pasi që nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar, Listën Përfundimtare, andaj si rezultat i këtij qëndrimi, rrjedh përfundimi se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet ligjore që kërkesëpadinë e paditësit, I C nga fshati S i E i Komunës së Vushtrrisë, e me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, t’ua paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSh-së, duhet refuzuar si të pa pabazuar.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsytetime tjera ligjore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), gjykata vendosi që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1, dhe nenit 72 par.2 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2023:101277, 31.05.2024**

Gjykatësi,
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).